

**Komentet e Kryetarit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri,
Ambasadorit Eugen Wollfarth, gjatë një vizite në Durrës**

24 prill 2012

Pyetje: Cili është qëllimi i vizitës suaj sot në Durrës?

Ambasadori Wollfarth: Durrësi është një port, qytet dhe destinacion turistik i rëndësishëm. Këto janë disa nga arsyet se përse jam në kontakt të vazhdueshëm me Kryetarin e Bashkisë Dako dhe se përse përpiqem të marr informacion të drejtpërdrejtë rreth zhvillimeve të këtushme. Zhvillimi i një qyteti si Durrësi shërben si një pasqyrë për ecurinë e zhvillimit të vendit. Siç e thashë, Durrësi është porti numër një i vendit. Pra, deri diku, është një kartëvizitë e rëndësishme e vendit. Gjithashtu, shkëmbyem mendime rreth zhvillimeve dhe shtrëngesave që vijnë si rezultat i buxhetit të kufizuar bashkiak. Natyrisht, Kryetari i Bashkisë ka për synim t'u sigurojë shërbimet më të mira qytetarëve, dhe ne po përpiqemi të mësojmë dhe të ndihmojmë, me qëllim që të nxjerrim konkluzione dhe të japim rekomandimet sa më të mira se si ta përmirësojmë jetën e qytetarëve. Më pëlqen gjithmonë të vij në Durrës. Një nga rastet ishte ceremonia e betimit tuaj [i drejtohet Kryetarit të Bashkisë Dako], pas rizgjedhjes në postin e Kryetarit të Bashkisë, vitin e kaluar.

Pyetje: Z. Ambasador, përfaqësuesit e 23 partive politike mbajtën një tryezë të rumbullakët dje rreth reformës zgjedhore, ndërkohë që partitë e mëdha mbeten në qëndrimet e tyre të vjetra. A duhen inkurajuar partitë që të mbajnë takime të tjera të ngjashme për një reformë zgjedhore konsensuale?

Ambasadori Wollfarth: Mendoj se është shumë e rëndësishme që të diskutohet së pari rreth reformës së Kodit Zgjedhor që po zhvillohet në komisionin e posaçëm parlamentar. Jo vetëm që është një gjë e kuptueshme, por besoj se është edhe një veprim tepër i rëndësishëm i partive të vogla diskutimi i aspekteve të ndryshme të sistemit zgjedhor. Veçanërisht kur partitë e vogla dëshirojnë të dëgjohen, platforma të tilla marrin një rëndësi të veçantë për t'i shprehur opinionet e tyre dhe, në qoftë se këto janë bindëse për një pjesë të madhe të spektrit politik, ato edhe mund të materializohen në të ardhmen.

Pyetje: Z. Ambasador, cili është qëndrimi i Prezencës së OSBE-së ndaj zgjedhjes të Presidentit të ri të vendit, duke pasur parasysh se vetëm pak javë na ndajnë prej fillimit të këtij procesi?

Ambasadori Wollfarth: Ne, në radhë të parë, shohim Kushtetutën dhe Kushtetuta e rregullon mënyrën se si duhet të zgjidhet President i Republikës. Tashmë, në fakt, po afrohet çasti kur duhen caktuar dhe prezantuar kandidatët. Prezenca e OSBE-së ua lë tërësisht në dorë qytetarëve, partive politike dhe sistemit politik shqiptar propozimin e kandidatëve për president. Është thelbësore që të identifikohen personalitete, që mund

ta drejtojnë institucionin në mënyrë shumë dinjitoze. Pushteti moral i këtij posti është veçanërisht i lartë dhe Shqipëria e qytetarët e saj meritojnë një shërbim sa më të mirë.

Pyetje: Z. Ambasador, në fund të muajit prill duhet të mbyllet puna e komisionit të posaçëm për reformën zgjedhore. A mendoni se reforma e Kodit Zgjedhor do të përmbillet pikërisht brenda asaj date?

Ambasadori Wollfarth: Siç e kam thënë edhe në raste të tjera, një produkt me cilësi të lartë ia kalon për nga rëndësia arritjes së një zgjidhjeje të shpejtë. Anëtarët e komisionit të posaçëm parlamentar dhe veçanërisht bashkëkryetarët e tij po punojnë me shumë intensitet, duke bërë një punë të mirë e të frytshme dhe kam besim se së bashku do të hartojnë një draft të mirë që do të paraqitet së shpejti. Nuk është e thënë patjetër atë ditë, por duhet të paraqitet sa më shpejt, sepse po afrohen data të tjera të rëndësishme, përfshirë zgjedhjen e Presidentit.

Pyetje: Çfarë mund të na thoni për ngjarjet në veriun e Kosovës dhe në Maqedoni dhe nëse do të kenë ndikim mbi vendin tonë?

Ambasadori Wollfarth: Më pëlqen shumë Shqipëria dhe shqiptarët dhe, ajo që admiroj më së shumti, është fakti që shqiptarët janë popull paqësor. Po ngurroj të përdor fjalën nacionalistë këtu, por shqiptarët janë krenarë për vendin e tyre, i cili sivjet feston 100 vjetorin e pavarësisë. Shqipëria ka marrëdhënie të hapura dhe të sinqerta me të gjithë fqinjët e saj dhe përfaqësuesit e saj zyrtarë, duke filluar nga Ministri i Punëve të Jashtme dhe duke vazhduar me zyrtarë të tjerë të lartë, e kanë bërë të qartë se qytetarët e cilitdo vend, kudo qofshin, duhet t'i qëndrojnë besnikë vendit të tyre. Ky është qëndrimi më i mirë që mund të mbahet: është një qëndrim paqeje dhe respekti, i cili do të ndihmojë që sytë të hidhen përpara drejt një të ardhmeje shumë të mirë të këtij rajoni.

Fund